REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
155/17
08.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova –RepublicofKosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELOZARAZMATRANJENABAVKE
PROCUREMENTREVIEËBODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	155/17		
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Ministria e Punëve të Brendshme - Parashtruesit të ankesës N.T.P **"YessPharma"** me seli në Prishtinë		
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP		
NGA:	Basri Fazliu, Ekspert shqyrtues i prokurimit_____ Kreshnik Spahiu, Ekspert teknik_____		
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik, lidhur me ankesën e parashtruar N.T.P **"YessPharma"** me seli në Prishtinë, me numër protokollit 155/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Skaner X-Ray dhe Detektor"**, me nr. të prokurimit:2017/214-17-701-1-2-1, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Punëve të Brendshme.		
Lokacioni:	Prishtinë	Data:	08/06/2017
PËR AKTIVITET			X

Bazuar në nenin 113.1 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Skaner X-Ray dhe Detektor", me nr. të prokurimit 2017/214-17-701-121, të Autoritetit Kontraktues, Ministria e Punëve të Brendshme**, si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues N.T.P **"YessPharma"**, me seli Prishtinë, me numër protokollit 155/17, të datës 25/05/2017.

Konform nenit *113.1*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti-teknik shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së. Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		01/06/2017		02/06/2017		08/06/2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 25/05/2017,Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE N.T.P **"YessPharma",** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Skaner X-Ray dhe Detektor"** me nr. të prokurimit 2017/214-17-701-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – **Ministria e Punëve të Brendshme**.
Konform nenit 113.1, Pjesa VIIIe LPP-së, Eksperti teknik shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatori Ekonomik Ankues: N.T.P **"YessPharma",** me seli Prishtinë

Pikat e Ankesës:

Pas dorëzimit te kërkesës për qasje ne dokumentet e tenderit, me datën 15.05.2017, perfaqeusesi i OE YESSPHARMA ka pasur qasje ne dosjen e tenderit te OE te rekomanduar për dhënie te kontratës, dhe bazuar ne dokumentacionin e analizuar ka gjetur disa parregullsi dhe mosplotësim te specifikacioneve teknik..! nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës dhe me këtë mendojmë se është shkelur LPP, : NENI 56, pika: 1 .1, 1.2, NENI 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve· Komisioni vlerësues ne shkelje te nenit 59. paragrafi 4, ka rekomanduar për kontrate kompaninë e cila nuk i plotëson specifikat e kërkuara ne dosje te tenderit.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

1. Skaner X-ray për kontrollimin e çantave: Te kjo pajisje pike se pari kemi mospërputhje te broshurave (ne dosje është prezantuar tjetër broshurë ndërsa pas kërkesës për sqarime shtese nga ana e AK-së, është prezantuar tjetër broshure pra ka mospërputhje mes këtyre dy dokumenteve).
Me poshtë janë te renditura specifikat te cilat nuk plotësohen nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës:

INSPECTON UNIT: Është kërkuar conveyerbelt 680 mm (adjustable), përgjigjia e AK-së, ndaj pyetjeve te OE ne lidhje me këtë pike ka qenë qe mund te ofertohet deri ne 700 mm, ndërsa është ofertuar 806 mm nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës.

DETECTIONCHARACTERISTICS: Është kërkuar Resolution 40 A WGguaranteed, 41 A WGtypical, është ofertuar me 38 AWG guaranteed, 40 A W Gtypical.

2. Detektor Metali: Edhe te kjo pajisje ka mospërputhje ne mes te broshurës se prezantuar dhe broshurave qe mund te gjenden ne web faqen e prodhuesit, për me tepër ka specifika te cilat nuk gjenden ne broshurat te cilat gjenden ne web faqen e prodhuesit e qe gjenden ne broshurat e prezantuara nga OE. Specifikat qe nuk plotësohen si me poshtë: është kërkuar në dosje: Capableofdetecting a Wide range ofthreat objects composed of magnetic, non-magnetic metals and mixed alloys; ndërsa është ofertuar: Detects metals regardless their orientation, dmth: nuk ceket askund se i detekton objektet magnetike, jo magnetike, metalet dhe përzierjet e metaleve qe është një

mangësi mjaft e madhe.

Është kërkuar Standard interface RS- 232 ndërsa nëse bëni një kërkim te thjeshte ne internet e gjeni se kjo pajisje nuk e ka këtë opsion por kjo çuditërisht gjendet ne broshurën e prezantuar nga OE.

Detektori i dorës (hand-held) : Specifikat te cilat nuk plotësohen nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës janë si me poshtë:

Është kërkuar ne dosje : Customizable via HHMD Configuration tool; ndërsa OE vetëm e ka konfirmuar me comply , nuk gjendet askund ne broshura.

Është kërkuar PD140N (withbatery): 390g, ndërsa është ofertuar nga OE 420-450gr.

Procesi i prokurimit:

- Data e njoftimit për kontratë në KRPP:.....13/03/2016
- Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedura e hapur
- Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....1.Furnizim / 2. E mesme
- Vlera e parashikuar e kontratës:.....50,000.00 €
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 05.08.2016
- Data e hapjes së ofertave:.....07.04.2017
- Data e njoftimit për dhënie të kontratës në KRPP:.....15.05.2017
- Kriter për dhënien e kontratës:.....Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët.

Kriteret për vlerësim:

Kërkesat e përshtatshmërisë:

a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për piken j deri ne q . ;

b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.

c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës(Dokumentet.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).

b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje).

c. Vërtetimin nga Gjykata ThemeloreDepartamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).

Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar të radhës.

Përshtatshmëria profesionale:

a. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit.Certifikata e TVSH;

b. Regjistrimi për numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës) për kompanitë vendore).

c. Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit- (kopje).

b. Certifikatën me numër fiskal (kopje).

c. Certifikata e TVSH-së (kopje).

Kapaciteti teknik dhe profesional:

a. Operatoret ekonomik duhen të dorëzojnë Autorizim origjinal nga prodhuesi ose përfaqesuesi i tij për shitje për produktet (X RaySkaner dhe Detektor metali) qe oferton;

b. Operatoret ekonomik duhet të sjellin Katalogë ose Broshura për Skaner X-ray, Detektor metali dhe detektor Dore. Katalogët ose broshurat duhet te jene te shoqëruara me përshkrim te detajuar te specifikimeve teknike te ofruara nga operatori ekonomik;

c. Operatoret ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë realizuar së paku një (1) kontratë për furnizime me Skaner X-ray në tri vitet e shkuara 2014, 2015, 2016.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare

a. Autorizim nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, origjinal ose i noterizuar nga origjinali .
b. Katalog ose broshurë
c. Listën e kontratave që specifikon: furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmi të përcjella me certifikatë të livrimit-dorëzimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje), të nënshkruara nga pranuesi i B05 Njoftim përKontratë furnizimeve/shërbimeve për kontratat e cekura në listë

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Emri i Operatorit Ekonomik	Vendi	Çmimi
1.	N.N. "Eho -04"	Prishtinë	37,937.00
2.	N.T.P "YessPharma"	Prishtinë	42,440.00
3	"Tetroniks" L.L.C	Prishtinë	39,498.00
4	"Armakos"	Prishtinë	33,283.00

Komisioni vlerësues pranë AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.59).
Më dt. 11 prill 2017, autoriteti kontraktues, ka caktuar komisionin për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në përbërje prej tre (3) anëtarëve, si në vijim:

- Ferat Berisha - Kryetar
- SylejmanAbdullahu - Anëtar
- Agim Islami -Anëtar

Data e mbarimit të vlerësimi:..... 05/05/2017
Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.... 10/05/2017

Raporti i komisionit vlerësues :

Bazuar në raportin për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se nga 2(dy) operatoret ekonomik që kanë ofertuan, ne aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Skaner X-Ray dhe Detektor", konstaton:**

Kompania Eho 04 nuk ka dorëzuar deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruar siç është kërkuar me dosjen e tenderit faqe 16 pika 3.1,andaj për këtë arsye kjo ofertë nuk kalon ne vlerësimin e mëtejme pasi nuk përmbush kriteret e përshtatshmërisë teknike.

Kompania Armakos nuk ka dorëzuar deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruar siç është kërkuar me dosjen e tenderit faqe 16 pika 3.1,andaj për këtë arsye kjo ofertë nuk kalon ne vlerësimin e mëtejme pasi nuk përmbush kriteret e përshtatshmërisë teknike.

Gjithashtu tek kompania Armakos, komisioni gjate krahasimit te specifikimeve teknike te kërkuara me dosjen e tenderit dhe broshurës se ofruar nga ana e operatorit ekonomik Armakos, ka vërejtur se artikujt e ofruar për pozicionin 1,2 dhe 3 nuk janë ne përputhje me kërkesat sipas Aneksit 1 te dosjes se tenderit dhe rrjedhimisht operatori ekonomik Armakos nuk kalon ne vlerësimin e mëtejme pasi nuk përmbush kriteret e përshtatshmërisë teknike.

Ne faqen 14 te raportit te komisionit, janë jep informata shtese, ku me date 28/04/2017 komisioni ka kërkuar sqarimin e tenderit.

Ne fund, komisioni pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit te ofertave te pranuara, rekomandon si operatore te përgjegjshme me çmimin me te ulet konsoriumin "Tektroniks&Elting" nga Prishtina me çmimin 39,498.92 Euro.

Raporti është nënshkruar nga komisioni me date 05/05/2017 dhe Zyrtari i prokurimit me date 10/05/2017.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113.1):

Eksperti Teknik-shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Eksperti teknik, në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifikimit teknik: Inspection unit – në dosjen e tenderit është kërkuar converybelt 680 mm (adjustable) përgjigja e AK-ja ndaj pyetjeve te OE mund të ofertohet deri në 700 ndërsa është ofertuar 806mm.

Eksperti teknik, në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifikimit teknik:

- Në dosjen e tenderit në Përshkrimin teknik të skanerit tek specifikimet teknik, pjesa Inspection Unit, kërkesa numër 4 conveyor belt height : 680 mm (adjustable)
- Në dokumentin me informatat sqaruese lidhur me tenderin në pyetjen Nr5 A mund të ofertohet pajisja e cila ka lartësi me te madhe te shirit transportues sesa ajo qe është kërkuar? P.sh 126 mm me e lartë sesa ajo qe është kërkuar.
- Në përgjigjen e AK-së është precizuar se Mund te Ofertohet deri ne 700 mm.
- Në ofertë eOETechtronics nëtabelën e specifikimeve teknike është i akordueshëm deri 806, mirëpo ne broshurën e produktit të ofertuar precizohet se lartësia e shirit transportues është 806 dhe nuk është evidentuar opsioni i "akordueshëm".

Konstatim i ekspertit teknik - Autoriteti kontraktues ka specifikuar ne informata sqaruese se lartësia e shiritit transportues mund të jete deri në 700 mm ndërsa operatori ekonomik ka ofruar produktin me lartësinë e shiritit transportues 806mm, rrjedhimisht specifikat e produktit te ofruar nuk përputhen me kërkesat e AK-së.

Eksperti teknik, në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifikimit teknik:: Detection characteristics- eshte kërkuar resolution 40 AËG guaranteed, 41 AËG typical është ofertuar 38 AËG guaranted ,40 AËG typical.

- Në dosjen e tenderit në Përshkrimin teknik të skanerit tek specifikimet teknik, pjesa Detection characteristics, është kërkuar Resolution 40 AËG guaranteed , 41 AËG typicall.

- Në ofertë e OE Techtronics në tabelën e specifikimeve teknike është shënuar po, konform. Nëse shikohet ne broshurën e produktit te ofruar nga operatori ekonomik ëire Resolution është 36 AËG guaranteed, 38 AËG typical.

Konstatim i ekspertit teknik - Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit në Përshkrimin teknik te skanerit tek specifikimet teknik, pjesa Detection characteristics ka specifikuar resolution 40 AËG guaranteed, 41 AËG typical, ndërsa operatori ekonomik ka ofruar produktin me Resolution 36 AËG guaranteed, 38 AËG typical, rrjedhimisht specifikat e produktit te ofruar nuk përputhen me kërkesat e AK-së.

I. Detektor metali

Eksperti teknik, në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifikimit teknik: Supozimi i shkeljes: ËshtëkërkuarCapableofdetecting a ëide range ofthreatobjectscomposedofmagnetic, non-magneticmetalsandmixedalloys; ndërsaështë ofertuar Detectsmetalsregardlesstheirorientation.

- Në dosjen e tenderit ne Përshkrimin teknik te Detektor metalik tek specifikimet teknik, pjesa Features(veqorite) Capableof detecting a ëide range ofthreat objects composedof magnetic, non-magnetic metal sandmixedalloys.

- Në ofertën e OE Techtronics në tabelën e specifikimeve teknike është shënuar po, konform. Në broshurën e produktit të ofertuar, është përshkruar se produkti mund ti detektoj metalet me ngjyre dhe metalet pa ngjyre.

Konstatim i ekspertit teknik - Në dosjen e tenderit në Përshkrimin teknik të Detektor metalik tek specifikimet teknik, pjesa Features (veçoritë) Capable of detecting a ëide range of threat objects composed of magnetic, non-magnetic metals and mixed alloys, ndërsa operatori ekonomik ka ofruar produktin i cili në broshurën e paraqitur specifikon "Capable to Detectboth Ferrousand Non-Ferrous Metallic Threat Objects Considered Dangerous by International Security". Sipas kësaj duke u bazuar në kategorizimin e përgjithësuar të metaleve, konsideroj se supozimi i shkeljes nuk qëndron dhe se specifikat e produktit te ofruar përputhen me kërkesat e AK-së.

Eksperti teknik, në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifikimit teknik: Supozimi i shkeljes: Është kërkuar Standard interface RS- 232 ndërsa nëse kërkohet në internet gjendet se kjo pajisje nuk e ka këtë opsion por kjo çuditërisht gjendet nëbroshurën e prezantuar nga OE.

- Në dosjen e tenderit nëPërshkrimin teknik te Detektor metalik tek specifikimet teknik, pjesa Features(veçoritë) është kërkuar Standard interfaceRS- 232.

- Nëdofertë e OETechtronics ne tabelën e specifikimeve teknike ështëshënuar po, konform. Nëse shikohet ne broshurën e produktit te ofruar nga operatori ekonomik ky opsion ekziston si opcional i paraqitur ne fund te broshurës "Optional -SCADASoftëare-Controlledremote data communicationandNetëorkingofMultiple Metal Detectors; Softëare to Changesettings by PC (Digitaloutput RS422, RS232 or RS485)"

- Broshura mund të gjendet në internet dhe gjithashtu edhe opsioni i këtij funksioni që mund te këtë kjo pajisje: http://english.elektral.com.tr/uploads/brosur/ThruScan%20Catalog-Eng%202016.pdf

Konstatim i ekspertit teknik - Në dosjen e tenderit ne Përshkrimin teknik te Detektor metalik tek specifikimet teknik, pjesa Features(veçoritë) është kërkuar Standard interfaceRS- 232. Ne broshurën e OETektroniks kjo kërkeseështëopsionale dhe rrjedhimisht kjo pajisje mund ta ketëkëtë funksion. Andaj, konsideroj se supozimi i shkeljes nuk qëndron dhe se specifikat e produktit të ofruar përputhen me kërkesat e AK-së.

II. Detektori i dorës

Eksperti teknik, në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifikimit teknik: Supozimi i shkeljes: Është kërkuar Customizablevia HHMD Configuration tool; ndërsa OE Tektrnokisvetëm e ka konfirmuar me comply, nuk gjendet askund në broshura.

- Në dosjen e tenderit ne Përshkrimin teknik te Detektor i dorës, tek specifikimet teknik, pjesa DetectionandOperationalfunctionsështëkërkuarCustomizableviaHHMDConfigurationtool.

- Nëofertën e OETechtronics ne tabelën e specifikimeve teknike është shënuar po,konform. Ndërsa ne broshurën e produktit të ofruar nuk specifikohet askund kjo kërkesë apo funksioni ekuivalent.

Konstatim i ekspertit teknik - Autoriteti kontraktues, në dosjen e tenderit në përshkrimin teknik te Detektor i dorës, tek specifikimet teknik, pjesa Detection and Operational functions është kërkuar Customizable via HHMD Configuration tool, ndërsa operatori ekonomik ka ofruar produktin në broshurën e produktit të ofruar nuk specifikohet askund kjo kërkesë apo funksioni ekuivalent, rrjedhimisht specifikat e produktit të ofruar nuk përputhen me kërkesat e AK-së.

1. **Supozimi i shkeljes:** Është kërkuar PD140N (ëithbatery): 390g, ndërsa është ofertuar nga OE 420-450gr. 5

   Në dosjen e tenderit ne Përshkrimin teknik te Detektor i dorës, tek specifikimet teknik, pjesa Carry Bag është kërkuar: PD140N (ëith batery): 390g.

   Në ofertën e OE Techtronics ne tabelën e specifikimeve teknike është shënuar po,konform. 490 gr. Gjithashtu ne broshurën e paraqitur vërtetohet se produkti ka këtë specifikim 490 gr.

Konstatim i ekspertit teknik - Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit në Përshkrimin teknik të Detektor i dorës, tek specifikimet teknik, pjesa Carry Bagësh të kërkuara PD140N (ëith batery): 390g, Në ofertën e OE Techtronics në tabelën e specifikimeve teknike është shënuar po, konform. 490 gr. Gjithashtu ne broshurën e paraqitur vërtetohet se produkti ka këtë specifikim 490 gr, rrjedhimisht specifikat e produktit te ofruar nuk përputhen me kërkesat e AK, mirëpo është e qarte se kjo kërkesë ka të beje me peshën e produktit e mospërputhja e evidentuar nuk paraqet pengese funksionale ne qëllimin për te cilin shërben produkti.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues Teknik:

Eksperti shqyrtues-teknik, duke u bazuar në konstatimet e lartë cekura nga ana ekspertit teknik,, i rekomandon panelit shqyrtues që të aprovoj pjesërishtë të BAZUARA ankesën OE ankues "Yess Pharma", me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të ANULOJ vendimin i dt. 15.05.2017 "Njoftimi për dhënien e kontratës", me nr. prokurimi: 657/17/1392/221", si i pabazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në RIVLERËSIM.